



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 26.03.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NËPËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR
PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II,
MALI I ZI – SHQIPËRI, ALOKIMET 2017”

- **Hyrje**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përg dhënie mendimi shqyrtoi në mbledhjen e datës 26.03.2019 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin *“Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit nëpërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për Programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, Alokimet 2017”*

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Zëvendësministri për Europën dhe Punët e Jashtme z. Sokol Dedja së bashku më stafin mbështetës.

Relator për shqyrtimin e projektligjit u caktua Z.Luan Harusha .

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Ky projektligj është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Qëllimi i këtij projektligji është të miratojë propozimin e projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2017.

Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga ana e Këshillit të Ministrave nëpërmjet vendimit nr.679, datë 14.11.2018, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2017” dhe është nënshkruar për palën shqiptare nga ana e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, më 14 dhjetor 2018.

Programi i bashkëpunimit Mali i Zi - Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program mbështet gjithashtu shkëmbimin e përvojës dhe njohurive ndërmjet përfituesve, si dhe përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale e lokale në zonën e programit. Programi në fjalë mbulon një territor prej 11 970 km², me një popullsi prej rreth 749 257 banorë

Në total, kontributi që do të japë Bashkimi Evropian për zbatimin e përbashkët të programit Mali i Zi – Shqipëri, për periudhën 2014 - 2020, arrin vlerën e 11 900 000 eurove, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Malit të Zi dhe Komisionit Evropian. Sjellim në vëmendje se, tri marrëveshje të tjera financimi janë konkluduar ndërmjet palëve për të njëjtin program (për alokimet e viteve 2014, 2015 e 2016), të cilat janë ratifikuar edhe nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (ligji nr.31/2016 dhe ligji nr.78/2018).

Përfitues të këtij programi do të jenë zonat, si më poshtë vijon:

Në Malin e Zi: *Andrijevisa, Berane, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë, Podgoricë, Cetinje, Danilovgrad, Budva, Bar dhe Ulqin.*

Në Shqipëri: Shkodra, Lezha, Rrethi i Tropojës.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike:

1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore e natyrore;
2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe e lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;
3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe e përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

Një tjetër aks prioritar do t'i dedikohet asistencës teknike prej rreth 1 190 000 eurosh për të gjithë periudhën e zbatimit 2014-2020, për të dyja vendet, duke përbërë 10% të buxhetit të përgjithshëm të programit. Kjo asistencë do të përdoret kryesisht për zbatimin efektiv, transparent e në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e strukturave kombëtare dhe atyre teknike.

- ***Përfundim***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare, duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit,

Relator

Luan HARUSHA

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ